

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot në Vlorë, më datë 26/01/2026, palët e mëposhtme bien dakord të lidhin këtë kontratë shitje kuotash (në vijim e referuar si "Kontrata") për kalim të një pjese të kapitalit të shoqërisë "DAKZ" Shpk (e regjistruar pranë regjistrit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) më datë 13/08/2020, me NUIS – M07013201T, me kapital 10 000 Leke (dhjetë mijë), me adresë Lagjja "Rilindja:" Rruga Transballkanike, Pallati i Ri, Kati 2, Shk.1 Vlorë, Shqipëri, ("Shoqëria"), si vijon:

SHITËSI:

- **Z. Agron Hyseni**, shtetas shqiptar, me atësi Laver, lindur në Vlorë më datë 02/06/1969, me banim në Tiranë, identifikuar me pasaportën shqiptare me nr. BG8588738, e me numer personal G90602056L, referuar në vijim se bashku si "Shitësi".

BLERËSI:

- **Z. Bernard Caushaj**, shtetas shqiptar, me atësi Ceno, lindur në Lushnjë më datë 24.10.1961, me banim në Tiranë, identifikuar me pasaportën shqiptare me nr. BE4437159 dhe me numër personal identifikimi G11024036O, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, (referuar në vijim se bashku si "Blerësi".

Shitësi dhe Blerësi do të referohen në këtë Kontratë veçmas si "Pala" dhe sëbashku si "Palët".

DUKE QENË SE:

- A) Shoqëria "DAKZ" Shpk është një shoqëri e organizuar sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar pranë regjistrit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) më datë 13/08/2020, me NUIS – M07013201T, me kapital 10 000 Leke (dhjetë mijë), e zotëruar 10% nga ortakut Z. Agron Hyseni, 56.6% nga ortakut Z. Shëqim Beshiri dhe 33.4% nga ortakut Z. Bernard Caushaj, me adresë Lagjja "Rilindja:" Rruga Transballkanike, Pallati i Ri, Kati 2, Shk.1 Vlorë, Shqipëri, ("Shoqëria"). Aktiviteti i "DAKZ" Sh.P.K, konsiston në: Ndërtim i të gjitha llojeve si banesa qytetare, ndërtime industriale dhe tregtare, komplekse uristike, autostrada, kanalizime, vepra të tjera të energjisë së rinovueshme. Punime hekuri, ndërtime armaturash, shtrim pllakash, berje mur tulle dhe beton arme, instalime elektrike e hidraulike. Aktivitet në fushën e tregëtisë, tregëtimi me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimorë, materjaleve të ndërtimit, pajisjeve hidrosanitare, elektrike dhe elektroshtepiake, pjesëve të këmbimit për automjete, pajisje zyrash, import eksport i tyre. Aktivitet në fushën e transportit, transport mallrash dhe pasagjere Brenda e jashtë vendit. Aktivitet në fushën e shërbimeve si punime me mjete të renda, gërmime, sisteme, shtrim rruge, hapje kanalesh etj. Hapjen e shfrytëzimit të kavave për prodhimin e inerteve dhe gureve që përdoren në ndërtim. Transport mallrash për vetë dhe për të tretet Brenda dhe jashtë vendit. Blerje/shitje makinash, motocikleta, motorra uji si dhe dhenien me qera të tyre. Investime në fushën e turizmit dhe shfrytëzim të plazhit, barit, hotelit, restorantit etj.
- B) Blerësi është i interesuar të blejë nga Shitësi, dhe Shitësi është i interesuar të shesë tek Blerësi 10 % të kapitalit të zotëruar nga Shitësi në Shoqëri, në vlerën e 1000 Leke (njemijë), sipas parashikimeve të kësaj Kontrate.
- C) Blerësi është njohur me aktet, dokumentacionin dhe gjendjen e Shoqërisë dhe nuk ka pretendime apo kërkesa ndaj Shitësit apo Shoqërisë;

Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

1. **Parashtrimet dhe shtojcat**
 - 1.1 Parashtrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse, plotësuese dhe e pandashme e kësaj Kontrate.
2. **Objekti i Kontratës**
 - 2.1 Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi Z. Agron Hyseni i kalon Blerësit Z. Bernard Caushaj nëpërmjet shitjes, 10 % te kapitalit të zotëruar nga Shitesi në Shoqëri, në vlerën e 1000 Leke (njemijë), dhe Blerësi pranon të blejë 10 % te kapitalit të zotëruar nga Shitesi në Shoqëri, në vlerën e 1000 Leke (njemijë), kundrejt pagesës së çmimit të shitjes, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
3. **Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës**
 - 3.1 Palët bien dakord se kuotat e kapitalit të "DAKZ" ShPK do të kalohen nepermjet shitjes nga Shitesi tek Blerësi, me një çmim shitjeje në vlerën nominale të kapitalit, çmim i cili në total do të jetë në shumën e 1,000 Leke (njemijë) ("Çmimi").
 - 3.2 Palët bien dakord se Çmimi i shitjes së kuotave do të paguhet nga Blerësi tek Shitësi si vijon:
 - i. 10 % te kapitalit të zotëruar nga Shitesi në Shoqëri, në vlerën e 1000 Leke (njemijë) do të transferohet nga Z. Hyseni tek Z. Caushaj, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate, dhe shuma prej 1,000 Leke (njemijë) do të paguhet brenda 5 ditë kalendarike nga lidhja e kësaj Kontrate, në llogarinë bankare të Shitësit, bashkëlidhur në këtë Kontratë.
 - 3.3 Me pagesën e Çmimit të transferimit të kuotave të Shoqërisë Blerësi sipas parashikimeve të kësaj Kontrate, Shitësi deklaron se nuk ka pretendime ndaj Blerësit.
4. **Kalimi i titullit të pronësisë mbi Kuotat**
 - 4.1 Kalimi i titullit të pronësisë mbi kuotat nga Shitësi tek Blerësi realizohet në datën e kësaj Kontrate. Blerësi pas regjistrimit të kësaj kontrate do të rezultojë:

Z. Bernard Caushaj do të ketë 43.40% te kapitalit të zotëruar në Shoqëri, në vlerën e 4,340 Leke (katërmijë e treqind e dyzete).

Z. Shkëlqim Beshiri do të ketë 56.60% te kapitalit të zotëruar në Shoqëri, në vlerën e 5,660 Leke (pesemijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë).
 - 4.2 Administratori i Shoqërisë, Z. Endrit Roshit ka shprehur pëlqimin e tij lidhur me këtë transferim të 10% te kuotave të Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e Statutit të Shoqërisë.
 - 4.3 Palët shprehen dhe bien dakord se pas kryerjes së pagesës së Çmimit nga Blerësi tek Shitësi për transferimin e 10% te kapitalit të Shoqërisë, ato nuk kanë pretendime ndaj njëra-tjetrës.
5. **Dispozita të ndryshme**
 - 5.1 Shitësi deklaron se është pronar i ligjshëm i kuotave që do të transferohen tek Blerësi, të cilat janë të lira nga çdo kufizim, peng apo barrë.
 - 5.2 Kjo Kontratë mund të zgjidhet apo ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Palëve. Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin mes Palëve në lidhje me këtë Kontratë do të gjykohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - 5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.
 - 5.3 Ndryshimet dhe shtesat e mundshme të kësaj Kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët.
 - 5.4 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë në gjuhën shqipe.



I bashkëlidhen si anekse kësaj Kontrate, dokumentet e mëposhtme:

1. Ekstrakti i shoqërisë "DAKZ" Shpk;
2. Kopje e dokumenteve të identifikimit të Palëve;
3. Të dhënat e llogarisë bankare të Shitësit.

SHITËSI

Agron Hyseni

Z. Agron Hyseni



BLERËSI

Bernard Caushaj

Z. Bernard Caushaj

